



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

Nr. 1124 Prot.

Gjirokastrë, më 14.09.2023

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ në Universitetin Aristotle të Selanikut.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Aristotle i Selanikut hap thirrjen për shkëmbim stafi me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndër-Institucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me **3 pozicione** për staf akademik dhe administrativ, **2** prej të cilëve do të angazhohen në mësimdhënie dhe **1** në trajnim në Universitetin Aristotle të Selanikut. Thirrja është e hapur për stafin e të tre fakulteteve. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht B2 ose greqisht B2.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **22.09.2023**:

- vërtetim punësimi;
- Letër Interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze në nivelin B2 ose të gjuhës greke në nivelin B2;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor do të përcjellë nominimet, përmes një platforme online në Universitetin e Selanikut për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Periodha 5-ditore e mobilitetit do të kryhet në periudhën janar-korrik 2024.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

